



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:208722

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05715177

C.nr.386/2018

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) me seli në Bulevardin “Bill Klinton” nr.3, ndërtesa e Elektro-Kosovës, kati II, nr.5 Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Arjana Mula zyrtare ligjore në KEDS, kundër të paditurit B. H. G. nga fshati K./Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Agron Kryeziu avokat në Malishevë, me objekt kontesti kompensim i dëmit material, vlera e kontestit 993.89 euro, gjatë mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor të datës 21.05.2024, të njëjtën ditë mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSTATOHET** se paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS), e ka tërhequr padinë që identifikohet në këtë gjykatë me numrin C.nr.386/2018 e datës 11.12.2018, kundër të paditurit B. H. G. nga fshati K./Malishevë,.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. (KEDS) ka ushtruar padi me datë 11.12.2018, kundër të paditurit B. H. G. nga fshati K./Malishevë, me objekt kontesti kompensim dëmi material, në vlerë prej 993.89 euro.

Lidhur me këtë, gjykata me datë 09.02.2024 ka nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi dhe të njëjtin ia ka dërguar të paditurit, i cili në përgjigje në padi ka theksuar se ai e ka kryer detyrimin-pagesën ndaj të paditëses KEDS në shumën prej 993.89 euro dhe ka kërkuar që të refuzohet padia e paditëses si e pabazuar.

Me datë 21.05.2024 prej orës 11:00, gjykata ka caktuar seancën kryesore ku prezent ka qenë e autorizuar e paditëses, ndërsa për të paditurin ka prezantuar përfaqësuesi i tij avokat Agron Kryeziu.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 21.05.2024, përfaqësuesja e paditëses Arjana Mula zyrtare Ligjore pranë Kompanisë për Distribim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), ka deklaruar se pas shikimit të transaksioneve të konsumatorit, vërtetohet se i padituri e ka përmbushur në tërësi dëmin e shkaktuar në vlerën prej 993.89 euro dhe po ashtu i padituri e ka paguar edhe taksën gjyqësore për padinë në vlerë prej 20.00 euro.

Andaj, meqenëse është përmbushur në tërësi dëmi i shkaktuar e po ashtu është bërë edhe pagesa e taksës gjyqësore, ka theksuar se e tërheqin padinë e datës 11.12.2018 ndaj të paditurit Bashkim Gashi.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtuara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.1 të LPK-së, i cili parasheh që: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*, ndërsa me nenin 261 par. 2 përcaktohet se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Bazuar në faktin se paditësja e ka tërhequr padinë në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në rastin konkret është pajtuar edhe i padituri, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Andaj, në një gjendje të këtillë, Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.386/2018, datë 21.05.2024

G j y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*